



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 15114 Prot

Vlorë, më 17.08 2025

Lënda: Njoftim për mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë, datë 22.09.2025.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORE
PREFEKTIT TË QARKUT VLORE**

Ju njoftoj se, **ditën e hënë, datë 22.09.2025, ora 10:00**, në Pallatin e Kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të Ligjit Nr. 139/2015, neni 53 pika 4, ku pas ;

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë, datë 18.08.2025.
2. Shprehje për ligjshmërinë e Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Nr 68 - 72, datë 18.08.2025;

Do të vazhdojmë me këtë rend dite:

1. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Gusht 2025”.
2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Gusht 2025”.
3. Projektvendim “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Besmir Shabani dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.
4. Projektvendim “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Kastriot Shyti dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.
5. Projektvendim “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Agron Çapaj dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.
6. “Për caktimin e nënkryetarit të bashkisë që do të ushtrojë përkohësisht funksionet e Kryetarit të Bashkisë Vlorë”.

Kryesia e Këshillit të Bashkisë, u mbledh në mjediset e Bashkisë Vlorë, ditën e mërkurë, datë 17.09.2025, ora 12:15.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :

Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike, do të mbledhet ditën e premte , datë 19.09.2025 , ora 10:00.

Komisioni i mandateve dhe rregullores, do të mbledhet ditën e premte , datë 19.09.2025, ora 11:00.

Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet, do të mbledhet ditën e premte datë 19.09.2025, ora 12:00.

V.O. Bazuar në rendin e ditës të sipërcituar, nëse ndonjë nga Komisionet e Përhershme, vlerëson se, duhet të mbledhet për çështjet që trajtojnë projektvendimet, Kryetari i Komisionit të njoftojë anëtarët e komisionit përkatës, për datën dhe orën e mbledhjes.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 15113 Prot.

Vlorë, më 17.09. 2025

VENDIM

Nr 10, datë 17.09.2025

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 17,53, pika 3, 56, pika 2 dhe Rregulloren “Për Organizmin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë” neni 60, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 17.09.2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë Vlorë, e cila do të mbahet në datën 22.09.2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit dhe, në mungesë të tij, Kryetari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Vlorë, Deputetët e Bashkisë Vlorë dhe personat apo/dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te Kryetari i Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri

